




PARIMET E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT TË SHELL



Parimet e përgjithshme të biznesit të Shell-it rregullojnë mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë nga secila shoqëri e Grupit Shell*.

*Royal Dutch Shell plc dhe shoqëritë të cilat ajo zotëron, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë persona juridikë të ndarë dhe të ndryshëm. Por në këtë botim, shprehjet përmbledhëse "Shell" dhe "Grupi Shell" mund të përdoren për lehtësi referimi kur bëhet fjalë për këto shoqëri në përgjithësi. Po kështu fjalët "ne", "neve" dhe "jona" në disa vende përdoren për t'iu referuar shoqërive të Grupit Shell në përgjithësi. Këto shprehje përdoren edhe kur nuk kanë për qëllim identifikimin e ndonjë shoqërie apo disa shoqërive të veçanta.

TË JETOSH SIPAS PARIMEVE TONA

Objektivat e Grupit Shell janë të angazhohet në mënyrë përfutuese, efikase dhe me përgjegjësi në biznesin e naftës, gazit, lëndëve kimike dhe në biznese të tjera të përzgjedhura, si dhe të marrë pjesë në kërkimin dhe zhvillimin e burime të tjera të energjisë për të plotësuar nevojat në rritje të klientëve dhe kërkesën botërore në rritje për energji.

Vlerat tona thelbësore të përbashkëta të ndershmërisë, integritetit dhe respektit për njerëzit qëndrojnë në bazë të punës që ne bëjmë dhe janë themeli i parimeve tona të biznesit.

Parimet e biznesit zbatohen për të gjithë transaksionet, të mëdha ose të vogla, dhe nxisin sjelljen që pritet nga çdo punëmarrës në çdo shoqëri të Shell-it gjatë ushtrimit së biznesit gjatë gjithë kohës.

Ne gjykojemi nga mënyra se si veprojmë. Reputacioni ynë ruhet nëse veprojmë në përputhje me ligjin dhe parimet e biznesit. Ne nxitim partnerët tanë të biznesit të jetojnë sipas këtyre parimeve ose sipas parimeve të barasvlershme.

Është përgjegjësia e drejtuesve që të udhëheqin duke dhënë shembullin vetjak, të sigurohen që të gjithë punëmarrësit t'i njohin këto parime dhe të veprojnë në përputhje me frymën dhe udhëzimet e këtij dokumenti.

Zbatimi i këtyre parimeve mbështetet nga një grup gjithëpërfshirës procedurash garancie, të cilat janë hartuar për të siguruar që punëmarrësit tanë të kuptojnë parimet dhe për të konfirmuar që ata veprojnë sipas tyre.

Pjesë e sistemit të garancisë është edhe përgjegjësia e drejtuesve për të vënë në dispozicion të punëmarrësve rrugë të sigurta e konfidenciale për ngritjen e shqetësimeve dhe raportimin e mospërputhjeve. Nga ana tjetër punëmarrësit e Shell-it kanë përgjegjësi që të raportojnë shkeljet e dyshuara të parimeve të biznesit të Shell-it.

Parimet e biznesit për shumë vite kanë qenë në themel të mënyrës se si ne kryejmë biznes dhe të jetuarit sipas tyre është thelbësore për suksesin tonë të vazhdueshëm.



Ben van Beurden
Drejtor Ekzekutiv

VLERAT TONA THELBËSORE



NDERSHMËRIA INTEGRITETI RESPEKTI

PARIMET TONA TË BIZNESIT

- EKONOMIA
- KONKURRENCA
- INTEGRITETI I BIZNESIT
- VEPRIMTARITË POLITIKE
- SHËNDETI, SIGURIA, MBROJTJA DHE MJEDISI
- KOMUNITETET LOKALE
- KOMUNIKIMI DHE ANGAZHIMI
- PAJTUESHMËRIA

VLERAT TONA

Punëmarrësit e Shell-it kanë një grup vlerash thelbësore të përbashkëta – ndershmërinë, integritetin dhe respektin për njerëzit. Ne besojmë vendosmërisht në rëndësinë thelbësore të besimit, transparencës, punës në grup dhe profesionalizmit, dhe krenohemi me punën që bëjmë.

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Si pjesë e parimeve të biznesit ne jemi përkushtuar që të kontribuojmë për zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo kërkon ekuilibrimin e interesave afatshkurtra dhe afatgjata duke integruar konsiderimet ekonomike, mjedisore dhe sociale në vendimmarrjen e biznesit.

PËRGJEGJËSITË

Përgjegjësia e shoqërive të Shell-it shtrihet në pesë fusha. Është detyra e drejtuesve që vazhdimisht të vlerësojnë prioritetet dhe t'i shpërndajnë këto përgjegjësi të pandashme mbi bazën e këtij vlerësimi.

a. Ndaj aksionarëve

Të mbrojnë investimin e aksionarëve dhe të ofrojnë një fitim afatgjatë konkurrues me atë të shoqërive të tjera lidere në industri.

b. Ndaj klientëve

Të fitojnë dhe të mbajnë klientët duke zhvilluar dhe ofruar produkte e shërbime me vlerë në drejtim të çmimit, cilësisë, sigurisë dhe ndikimit mjedisor, që mbështeten nga ekspertiza e nevojshme teknologjike, mjedisore dhe tregtare.

c. Ndaj punëmarrësve

Të respektojnë të drejtat e njeriut që gëzojnë punëmarrësit tanë dhe t'u ofrojnë atyre kushte të mira dhe të sigurta pune si edhe kushte konkurruese punësimi.

Të nxisin zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më të mirë të talenteve të punëmarrësve tanë; të krijojnë një mjedis pune përfshirës ku çdo punëmarrës të ketë mundësi të barabarta për të zhvilluar aftësitë dhe talentet e tij/saj. Të nxisin përfshirjen e punëmarrësve në planifikimin dhe drejtimin e punës së tyre; t'u sigurojnë atyre rrugët për të raportuar shqetësimet.

Ne pranojmë se suksesi tregtar varet nga përkushtimi i plotë i të gjithë punëmarrësve.

d. Ndaj atyre me të cilët bëjmë biznes

Përpjekja për krijimin e marrëdhënieve me përfitim të ndërsjellë me kontraktorët, furnizuesit dhe shoqëritë e përbashkëta, si dhe nxitja e zbatimit të këtyre parimeve të përgjithshme të biznesit të Shell-it ose parimeve të ngjashme me to, në këto marrëdhënie. Aftësia për të nxitur efektivisht këto parime është faktor i rëndësishëm në vendimin për të krijuar ose vazhduar marrëdhënie të tilla.

e. Ndaj shoqërisë

Të kryejnë biznes si anëtarë korporate të përgjegjshëm të shoqërisë të veprojnë në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, të mbështesin të drejtat themelore të njeriut sipas funksionit të ligjshëm të biznesit dhe t'i kushtojnë kujdesin e duhur shëndetit, mbrojtjes, sigurisë dhe mjedisit.

PARIMI 1

EKONOMIA

Fitimi afatgjatë është thelbësor për të arritur qëllimet tona të biznesit dhe për rritjen tonë të vazhdueshme. Ai është matës i efikasitetit dhe vlerës që klientët i japin produkteve dhe shërbimeve të Shell-it. Ai ushqen burimet e nevojshme të korporatës për investimin e vazhdueshëm që kërkohet për të zhvilluar dhe prodhuar furnizimet e energjisë në të ardhmen për të përmbushur nevojat e klientit. Pa fitime dhe pa një bazë të fortë financiare do të ishte e pamundur që të përmbushnim përgjegjësitë tona.

Kriteret për marrjen e vendimeve lidhur me investime dhe tjetërsime të investimeve përfshijnë gjykimet për zhvillimin e qëndrueshëm (ekonomik, social dhe mjedisor) dhe një vlerësim të rreziqeve të investimit.

PARIMI 2

KONKURRENCA

Shoqëritë Shell mbështetin sipërmarrjen e lirë. Ne kërkojmë të konkurrojmë në mënyrë të ndershme dhe etike si dhe brenda kuadrit ligjor në fuqi për konkurrencën; ne nuk pengojmë të tjerët të na konkurrojnë lirisht.

PARIMI 3

INTEGRITETI I BIZNESIT

Shoqëritë Shell vënë theksin te ndershmëria, integriteti dhe drejtësia në të gjitha aspektet e biznesit tonë dhe presim të njëjtën gjë në marrëdhëniet tona me të gjithë ata me të cilët bëjmë biznes. Ofrimi, kërkimi, pagimi ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i mitës së çfarëdolloj forme, është i papranueshëm. Pagesat për lehtësimin e procedurave konsiderohen gjithashtu mitë dhe nuk duhen bërë. Punëmarrësit duhet të shmangin konfliktet e interesit ndërmjet veprimtarive të tyre private dhe rolit të tyre në kryerjen e biznesit të shoqërisë. Gjithashtu, punëmarrësit duhet të deklarojnë te shoqëria e tyre punëdhënëse çdo konflikt të mundshëm interesi. Të gjithë transaksionet tregtare në emër të një shoqërie Shell duhet të pasqyrohen saktësisht dhe ndershmërisht në llogaritë e shoqërisë sipas procedurave të përcaktuara dhe janë objekt i kontrollit dhe transparencës.

PARIMI 4

VEPRIMTARITË POLITIKE

a. Të shoqërive

Shoqëritë Shell veprojnë në mënyrë të përgjegjshme nga pikëpamja sociale, sipas ligjeve të vendeve në të cilat operojmë për të arritur objektivat tona të ligjshme tregtare.

Shoqëritë Shell nuk kryejnë pagesa në favor të partive politike, organizatave apo përfaqësuesve të tyre. Shoqëritë Shell nuk marrin pjesë në parti politike. Megjithatë, kur hyjnë në marrëdhënie me qeveritë, shoqëritë Shell kanë të drejtën dhe përgjegjësinë që ta bëjnë të njohur qëndrimin tonë për çdo çështje që na prek ne, punëmarrësit, klientët, aksionarët tanë ose komunitetet lokale në një mënyrë që përputhet me vlerat dhe parimet tona të biznesit.

b. Të punëmarrësve

Kur individët dëshirojnë të angazhohen në veprimtari në komunitet, duke përfshirë kandidimin për zgjedhje për një post publik, atyre do t'u jepet mundësia ta bëjnë diçka të tillë, aty ku është e përshtatshme, në varësi të rrethanave lokale.

PARIMI 5

SHËNDETI, MBROJTJA, SIGURIA DHE MJEDISI

Shoqëritë Shell kanë një qasje sistematike ndaj shëndetit, mbrojtjes, sigurisë dhe menaxhimit të mjedisit për të arritur përmirësime të vazhdueshme të performancës.

Për këtë qëllim shoqëritë Shell i menaxhojnë këto çështje si veprimtari të domosdoshme të biznesit, vendosin standarde dhe qëllime për përmirësimin dhe matin, vlerësojnë dhe raportojnë performancën nga jashtë.

Ne vazhdimisht kërkojmë mënyra se si të ulim ndikimin e operacioneve, produkteve dhe shërbimeve tona në mjedis.

PARIMI 6

KOMUNITETET LOKALE

Shoqëritë Shell synojnë të jenë fqinjë të mirë duke përmirësuar vazhdimisht mënyrat se si ne kontribuojmë drejtpërdrejt ose tërthorazi në mirëqenien e përgjithshme të komuniteteve brenda të cilave punojmë.

Ne i menaxhojmë me kujdes ndikimet e veprimtarive tona të biznesit dhe punojmë me të tjerët për të rritur përfitimet e komuniteteve lokale dhe për të zbutur ndonjë ndikim negativ nga veprimtaritë tona.

Përveç kësaj, shoqëritë Shell tregojnë interes konstruktiv ndaj çështjeve shoqërore që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprimtarinë tonë.

PARIMI 7

COMMUNICATION AND ENGAGEMENT


Shoqëritë Shell pranojnë se dialogu dhe angazhimi i rregullt me aksionarët tanë është thelbësor. Ne jemi të përkushtuar që ta raportojmë performancën tonë duke ofruar informacionin e plotë përkatës për palët e interesuara sipas rregullave, duke respektuar çdo konsiderim të rëndësishëm për konfidencialitetin e biznesit.

Gjatë komunikimeve tona me punëmarrësit, partnerët e biznesit dhe komunitetet lokale ne përpiqemi që t'i dëgjojmë dhe t'u përgjigjemi atyre me ndershmëri dhe përgjegjësi.

PARIMI 8

PAJTUESHMËRIA

Ne veprojmë në pajtim me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në vendet ku ushtrojmë veprimtari tregtare.



© Shell International Limited 2014

Për riprodhimin e ndonjë pjese të këtij publikimi duhet t'i kërkohet leje Shell International Limited.

Zakonisht kjo leje jepet me kusht që të njihet burimi.

Botimi i parë i dokumentit të Parimeve të përgjithshme të biznesit u publikua në vitin 1976.

Më pas u përditësua në vitin 1984, 1988, 1990, 1994, 1997 dhe 2005.

Në rast mospërputhjeje midis versionit të përkthyer dhe versionit në anglisht, versioni në anglisht do të mbizotërojë.

